



PËR: z. Ardian Mehmetaj, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;

CC: z. Avdullah Hoti, Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës;
z. Armend Zemaj, Ministër i Shëndetësisë;
znj. Albena Reshitaj, Kryetare e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
z. Visar Berisha, Këshilltar i kryeministrit;
z. Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore pranë ZKM-së;
znj. Afërdita Hoxha, ud. Drejtor, Departamentit Ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë;

NGA: Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.Sci., Kryetar, Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK);
Prof. Dr. Blerim Kamberi, Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës (OSK);
Dr.sc. Arianit Jakupi, Kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës (OFK);
Ma. Bsc.. Naser Rrustemi, Kryetar i Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK);
Ass.Msci. Feim Gashi PT, Kryetar i Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës (OFTK);

LËNDA: Përjashtimi i Odave të Profesionistëve Shëndetësor nga proceset e nismave legislative për hartimin e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi

Datë: 11 gusht 2020

I nderuar,

Me shqetësim kemi kuptuar se nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, me datë 07.08.2020 është nxjerrë Vendimi nr. 05-4948, me të cilin është themeluar ekipi mbështetës i zyrtarit përgjegjës për hartimin e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi, në të cilin në mënyrë arbitrare nuk janë përfshirë përfaqësuesit e Odave të Profesionistëve Shëndetësor.

Pra, me këtë veprim i është mohuar përfaqësimi i profesionistëve shëndetësorë përmes përfaqësuesëve të tyre legjitim.

Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi është ligj organik dhe sistemor, i cili paraqet bazën themelore ligjore mbi të cilën rregullohet sistemi shëndetësor i cili ka karakter unik. Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësor është akt komplementar i cili themelon organizatat e përfaqësimit profesional të profesionistëve shëndetësor. Duke qenë sistem unik, çdo rregullim që ka të bëjë me sistemin shëndetësor, është më se e detyrueshme që Odat e Profesionistëve Shëndetësor të jenë të implikuara dhe të përfshira në nismat legislative, për të

mundësuar hartimin harmonik të projektligjit i cili do të duhej të ketë për qëllim avansimin e sistemit shëndetësor dhe jo për ta vënë në regres të njëjtin.

Përfshirja e Odave të Profesionistëve Shëndetësorë nuk është dëshirë e as diskrecion i asnjë zyrtari të cilitdo institucioni publik, por është detyrim ligjor. Autorizimi i tillë ligjor i Odave të Profesionistëve Shëndetësorë buron nga dispozita e Nenit 10, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.5 të Ligjit nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, sipas të cilit Odat në kuadër të kompetencave ligjore **bashkëpunojnë për përgatitjen e ligjeve**, dokumenteve si dhe akteve të tjera nënligjore në sektorin e shëndetësisë si dhe **mbikëqyrin zbatimin e tyre**.

Prandaj, në cënim të dispozitave të Ligjit nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, Vendimi nr. 05-4948 është nxjerrë edhe në kundërshtim të dispozitave të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, respektivisht Nenin 9, paragrafin 5, pasi që ekipi mbështetës emërohet sipas **nevojës** dhe propozimit të zyrtarit përgjegjës që e harton draftin fillestar të projektligjit përkatës. Dispozita e tillë përfshinë nevojën, eë pa asnjë dyshim detyrimi ligjor është nevojë por edhe obligacion në kuptim juridik.

Idea dhe qëllimi i dispozitës ligjore, por edhe të asaj nënligjore, është që në procesin e hartimit të projektligjeve të përfshihen akterët themelor të sektorit në të cilin projektligji do të ketë efekt juridik, kështu që me këtë qasje anashkalohet çdo arbitraritet juridik që mund të shkaktojë procesi i tillë i hartimit legjislativ.

Ne konsiderojmë se përjashtimi nga proceset e nismave legjislative dhe procedurave të veçanta dhe të ndërmjetme të hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar, dëmton rëndë kornizën ligjore ekzistuese, por edhe karakterin e procesit transparent e demokratik të hartimit legjislativ.

Andaj, për të gjitha këto arsye, ne kërkojmë nga Ju si autoritet kompetent, rrespektimin dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, duke siguruar përfaqësimin e Odave të Profesionistëve Shëndetësorë në këtë ekip mbështetës, por jo vetëm.

Ne shpresojmë se kjo kërkesë e përbashkët e Odave të Profesionistëve Shëndetësorë do të merret në konsideratë dhe se ligjshmëria në këtë proces .

Me respekt,

Prishtinë, 11 gusht 2020

Kryetar i OMK-së

Dr. Pleurat
Sejdiu, Mr. sci

Kryetar i OSK-së

Prof. Dr. Blerim
Kamberi

Kryetar i OIK-ut

Ma. Bse., Naser
Rrustemi

Kryetar i OFK-së

Dr. sc. Arianit
Jakupi

Kryetar i OFTK-së

Ass. Msci. Feim Gashi
PT